



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË**

Elbasan, më 24.02.2023

**Lënda: Tematika e testimit me shkrim për pranimin në programin e studimit “doktoratë
në albanologji”**

PROFILI GJUHËSI

1. Tipologji e studimeve gjuhësore shqiptare: studimi shkencor i kuptimit: semantika, leksikologjia, leksikografia
2. Leksema, koncepti për të në kohë dhe shkolla të ndryshme. Identiteti i fjalës dhe i variantave të saj fonografike në gjuhën shqipe.
 - Fjala, termi dhe norma gjuhësore. Termi dhe terminologjia. Leksiku terminologjik dhe leksiku i përgjithshëm. Terminologjia në fjalorë (terminografia)
 - 3. Përbërja e leksikut të gjuhës. Shqipja standarde dhe leksiku i saj.
 - Lëvizje në leksikun e gjuhës së sotme shqipe
 - Krahinorizmat në fjalorë të gjuhës shqipe
 - Dialektorizmat dhe krahinorizmat. Trajtimi leksikografik i dialektorizmave dhe i krahinorizmave
4. Koncepti i fjalorit pasiv dhe fjalorit aktiv në gjuhë.
5. Koncepti i korpusit përdorimor, korpusi i leksikut aktiv
6. Semasiologjia leksikore, objekti dhe metodat e studimit. Kufijtë e semasiologjisë leksikore; Kuptimi për semantikën leksikore si sistem i veçantë; Konceptet themelore të semantikës leksikore.
7. Kategoritë themelore të semantikës. Lëvizja kuptimore sipas tropeve (figurave) gjuhësore. Teoria e fushave. Semantika bashkëkohore, tiparet veçantitë, teoritë kryesore, tendencat

8. Konceptet themelore të morfologjisë si disiplinë e gramatikës.

- Trajtimi i pjesëve të ligjërata sipas gramatikanëve bashkëkohorë në “pjesë ligjërate të rangut kryesor” dhe “jokryesor”.

- Ndarja e tyre në kategori gramatikore parësore, dytësore dhe funksionale.

9. Proceset fjalëformuese dhe formëformuese.

- Koncepti i morfemës, morfit dhe alomorfit.

- Shfaqje të alomorfisë në sistemin emëror dhe foljor të shqipes.

10. Modelet kryesore fjalëformuese të shqipes.

- Çështje problemore, bashkëkohore lidhur me mënyrat e fjalëformimit.

- Mjetet fjalëformuese. Llojet e morfemave: rrëniore dhe ndajshtesore.

11. Koncepti i rasës dhe shquarsisë në gjuhën shqipe.

- Varësia e ndërsjellë midis rasës dhe gjinisë në gjuhët indoeuropeiane.

12. Kategoritë gramatikore të kohës, mënyrës dhe aspektit, “i kryer” apo “i pakryer”.

- Gërshetimi i kohës me mënyrën. Çështje problemore rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime.

13. Marrëdhëniet ndërgjuhësore: rezultati i marrëdhënieve ndërgjuhësore,

- klasifikimi i fjalëve të fituara nga gjuhë të tjera,

- fjalët huazime, fjalët e huazuara dhe fjalët e huaja.


14. Mikrotoponimia: inventarizimi i mikrotponimeve, lidhja me rrëthanat gjeografike, lidhja me rrëthanat historike, lidhja me gjuhë të tjera, etimologjia e mikrotponimeve.

15. Gjuha si element kulture: Fjalë të reja që hyjnë nga gjuha letrare dhe bashkë me sende e ide të reja. Funksionet e gjuhës standarde.

16. Zhvillimet gjuhësore në kuadrin e globalizmit.

17. Ndryshimi dhe zhvillimi gjuhësor.

18. Varietete gjuhësore: funksionale, shoqërore, kontekstuale “Nuk ka variacion gjuhësor krejt të lirë”

Drejtuese e departamentit

Prof. dr. Teuta Toska